



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 887/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/1-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Validohet vendimi për zgjatje të akreditimit të Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM) për periudhën I tetor 2024 – 30 shtator 2025:
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Publik Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM) ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për validim të zgjatjes së akreditimit si në dispozitiv të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatës së akreditimit të lëshuar nga agjencia Gjermane e akreditimit Evalag dhe dëshmive të ofruara me kërkesë.

Meqenëse Kolegji Publik Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM) është në proces të transformimit/transicionit nga një institucion privat i arsimit të lartë në institucion publik, KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Nasnja Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë